



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës * Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 525/24 Dt. 30.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejin e realizimit të një punëtorie për hartimin e raportit të të gjeturave gjatë procesit të implementimit të projektit “Vizitat shëndetësore sistematike” në shkollat fillore të mesme të ulëta të Komunës së Prizrenit, për nxënësit e klasave I, V, IX, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare dhe shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Punëtorja do të realizohet jashtë vendit ku do të merr pjesë stafi i cili ka realizuar vizitat sistematike dhe do të zgjatë (do të jetë) 3 ditë e dy 2 net.
3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shëndetësisë-mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

